



MËSIME TË RËNDËSISHME PËR POPULLIN E THJESHTË

ABDULAZIZ IBËN ABDULLAH IBËN BAZ



MËSIMETË RËNDËSISHME PËR POPULLIN E THJESHTË

NGA SHEJHU I NDERUAR:

ABDULAZIZ IBËN ABDULLAH
IBËN BAZ

Titulli original: الدروس المهمة لعامة الأمة

Ed-durusu el muhimmetu li āmmetil ummeti

Titulli i plotë: Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë

Autor: AbdulAziz ibën Abdullah ibën Baz

Përktheu: Besmir Cacani

Publikimi në web: www.revistamedina.net

© të gjitha të drejtat janë të rezervuara për përkthyesin

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Hyrje

Lavdi Allahut, Zotit të krijesave. Përfundimi i mirë i përket njerëzve të devotshëm, lavdërimi dhe shpëtimi qofshin mbi robin dhe peygamberin e Allahut, të Dërguarin tonë Muhamed, familjen dhe gjithë shokët e tij.

Më pas:

Këto janë disa fjalë të përmbledhura, që sqarojnë disa çështje që masa e gjerë e njerëzve duhet t'i dinë rreth fesë Islame dhe i titullova: "Mësime të rëndësishme për popullin e thjeshtë".

E lus Allahun që t'i bëjë të dobishme për muslimanët dhe t'i pranojë nga unë, me të vërtetë Ai është Bujar dhe Dhurues i mirësive.

AbdulAziz ibën Abullah ibën Baz

MËSIMET E RËNDËSISHME PËR POPULLIN E THJESHTË¹

Mësimi i parë

SURJA EL FATIHA DHE SURET E SHKURTA

T'i mësosh suren el Fatiha dhe suret e shkurta që janë të mundura, duke filluar nga surja ez-Zelzeleh deri tek surja en-Nas, duke ia korigjuar leximin, duke ia mësuar përmendësh dhe duke ia shpjeguar atë që duhet të kuptohet.

Mësimi i dytë

SHTYLLAT E ISLAMIT

Sqarimi i pesë shtyllave të Islamit. Shtylla e parë dhe më madhështorja është: dëshmia La ilahe il-lAllah (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut) dhe Muhamedun resulullah (Muhamedi është i Dërguari i Allahut). Shpjegimi i domethënies së saja dhe sqarimi i kushteve të fjalës La ilahe il-lAllah. Domethënia e saj është: "La ilahe" mohon çdo gjë që adhurohet përveç Allahut, "il-lAllah" pohon se adhurimi i takon Allahut të Vetëm e të pashoq.

Sa i përket kushteve të fjalës La ilahe il-lAllah, ato janë:

¹ Publikuar në librin "Mexhmu' fetaua ue makalat metenevvia" vëllimi 3 faqet 288-298 të autorit të nderuar.

1. Dituria, e kundërta e injorancës.
2. Bindja, e kundërta e dyshimit.
3. Përkushtimi, i kundërta i shirkut.
4. Singëriteti, e kundërta e gënjeshtërsë.
5. Dashuria, e kundërta e urrejtjes.
6. Nënshtrimi, i kundërta i lënies.
7. Pranimi, i kundërta i refuzimit.
8. Mohimi i çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut.

Këto kushte janë mbledhur në dy vargje poezie:

Dituri, bindje, përkushtim dhe besnikëri

Dashuri, nënshtrim dhe pranim i saj

Shtoji të tetën, që është të mohosh

Çdo gjë që adhurohet përveç Allahut.

Sqarimi i dëshmisë Muhamedun resulullah, kuptimi i së cilës është: besimi i tij për çfarë ka lajmëruar, bindja e tij për çfarë ka urdhëruar, distancimi nga gjërat që ka ndaluar dhe qortuar, e të adhurohet Allahu vetëm me gjërat që i ka ligjëruar Allahu azze ue xhel-le dhe Pejgamberi i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Më pas, i sqaron nxënësit pjesën e mbetur të shtyllave të Islamit, që janë: namazi, zekati, agjërimi dhe haxhi në Shtëpinë e Shenjtë të Allahut, për atë që ka mundësi të shkojë.

Mësimi i tretë

SHTYLLAT E IMANIT

Shtyllat e Imanit janë gjashtë: të besosh Allahun, melaiKET e Tij, Librat e Tij, peJgamberët e Tij, Ditën e Gjykimit, të besosh në caktimin e mirë apo të keq se është nga Allahu i Lartësuar.

Mësimi i katërt

LLOJET E TEUHIDIT DHE LLOJET E SHIRKUT

Sqarimi i llojeve të Teuhidit, të cilat janë tre: Teuhidi Rrububije, Teuhidi Uluhije dhe Teuhidi el Esmā' ues-sifat.

Sa i përket **Teuhidit Rrububije**: është të besosh se Allahu i Lartësuar është Krijuesi i çdo gjëje, Ai që drejton çdo gjë dhe nuk ka ortak në to.

Sa i përket **Teuhidit Uluhije**: është të besosh se Allahu i Lartësuar është i Adhuruari me të drejtë, nuk ka ortak në këtë gjë, e kjo është domethënia e fjalës La ilahe il-Allah. Domethënia e fjalës La ilahe il-Allah është: nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut. Të gjitha adhurimet, sikur namazi, agjërimi etj, duhet t'i kushtohen Allahut të Vetëm dhe nuk lejohet t'ia kushtosh diçka prej adhurimeve dikujt tjetër veç Tij.

Sa i përket **Teuhidit el Esmā' ues-sifat**: është të besosh çdo emër dhe cilësi të Allahut që është përmendur në Kuranin Fisnik, apo në hadithet e sakta. Ato duhet t'i pohohen vetëm

Allahut, sipas formës që i përshtatet Atij, pa devijim, pa mohim, pa përskrim dhe përngjasim, duke vepruar sipas thënies së Allahut të Lartësuar:

﴿ قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ۝ اللَّهُ الصَّمَدُ ۝ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُولَدْ ۝ وَلَمْ يَكُن لَّهُ
كُفُوًا أَحَدٌ ۝ ﴾ الإخلاص: ١ - ٤

“Thuaj: “Allahu është Një. Allahu është *es-Samed* (i Ploti në cilësitë e Tij, për të Cilin kanë nevojë të gjitha krijesat). Ai nuk ka lindur dikë, as është i lindur nga dikush dhe dhe as që ka dikë të barabart.” [Surja el Ikhlas e plotë].

Po ashtu, sipas thënies së Tij azze ue xhel-le:

﴿ لَيْسَ كَمِثْلِهِ شَيْءٌ وَهُوَ السَّمِيعُ الْبَصِيرُ ۝ ﴾ الشورى: ١١

“Asgjë nuk i ngjan Atij. Ai është Dëgjuesi dhe Shikuesi.” [Esh-Shura: 11].

Disa dijetarë e kanë ndarë Teuhidin në dy lloje, duke e futur Teuhidin el Esma’ ues-sifat tek Teuhidi Rrububije. Këtu nuk ka ndonjë mospajtim, sepse qëllimi është i qartë nga secila ndarje.

Llojet e shirkut janë tre: shirk i madh, i vogël dhe i fshehtë.

Shirku i madh: i asgjëson veprat dhe bën që njeriu të qëndrojë në Zjarr përgjithmonë nëse vdes në të, siç thotë Allahu i Lartësuar:

﴿ وَلَوْ أَشْرَكُوا لَحِطَّ عَنْهُمْ مَا كَانُوا يَعْمَلُونَ ۝ ﴾ الأنعام: ٨٨

“E po t’i bënin shirk (Allahut), atyre do t’u asgjësoheshin veprat që i kanë bërë.” [El En’am: 88].

Allahu i Lartësuar gjithashtu ka thënë:

﴿ مَا كَانَ لِلْمُشْرِكِينَ أَنْ يَعْمُرُوا مَسْجِدَ اللَّهِ شَاهِدِينَ عَلَىٰ أَنْفُسِهِمْ بِالْكُفْرِ ۗ

أُولَٰئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي النَّارِ هُمْ خَالِدُونَ ﴿٧٧﴾ ﴿التوبة: ١٧﴾

"Nuk i takon idhujtarëve (atyrë që i bëjnë Allahut shirk) që të ndërtojnë xhamiat e Allahut, përderisa edhe ata vetë dëshmojnë se janë mosbesimtarë. Të kota do të jenë vepra e tyre dhe në zjarrin e Xhehenemit do të qëndrojnë përgjithmonë." [Et-Teube: 17].

Po ashtu, ai që vdes në shirk nuk do të falet dhe do ta ketë të ndaluar hyrjen në Xhenet, siç ka thënë Allahu azze ue xhel-le:

﴿ إِنَّ اللَّهَ لَا يَغْفِرُ أَنْ يُشْرَكَ بِهِ وَيَغْفِرُ مَا دُونَ ذَلِكَ لِمَنْ يَشَاءُ ۗ ﴾ ﴿النساء: ٤٨﴾

"Vërtet Allahu nuk fal që t'i bëhet Atij diçka shirk dhe, fal çdo gjë tjetër atij që dëshiron." [En-Nisa': 48].

Po ashtu ka thënë i Lartësuari:

﴿ إِنَّهُ مَنْ يُشْرِكْ بِاللَّهِ فَقَدْ حَرَّمَ اللَّهُ عَلَيْهِ الْجَنَّةَ وَمَأْوَهُ النَّارُ وَمَا

لِلظَّالِمِينَ مِنْ أَنْصَارٍ ﴿٧٢﴾ ﴿المائدة: ٧٢﴾

"Vërtet ai që i bën Allahut ortak, Allahu ia bën të ndaluar hyrjen në Xhenet, përfundimi i tij do të jetë Zjarri dhe nuk do të ketë ndihmues për zullumqarët." [El Maideh: 72].

Prej llojeve të shirkut të madh janë: lutja e të vdekurve, lutja e idhujve, të kërkosh tyre shpëtim, zotimi për ta, bërja kurban për ta dhe të ngjashme.

Shirku i vogël: është ai që emërtohet në tekstet e Kuranit dhe Sunetit se është shirk, mirëpo nuk është nga lloji i shirkut të madh, sikur syfaqësia në disa punë, betimi për dikë tjetër veç Allahut, thënia "çfarë dëshiroi Allahu dhe filani" apo të ngjashme.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Gjëja që më shumë frikësohem për ju është shirku i vogël.”** Ai u pyet rreth tij dhe tha: **“Syfaqësia.”** E transmetojnë imam Ahmedi, Taberani dhe Bejhakiu nga Lebijd el Ensarij radijAllahu anhu me zinxhir transmetimi të mirë. Po ashtu e ka transmetuar Taberani me zinxhire të mira transmetimi, nga Mahmud ibën Lebijd, nga Rafi’ ibën Hadijxh, nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kush betohet për dikë tjetër veç Allahut, vetëm se ka bërë kufër apo shirk.”**

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Mos thoni “çfarë dëshiroi Allahu dhe filani”, mirëpo thoni “çfarë dëshiroi Allahu pastaj filani”.** E transmeton Ebu Daudi me zinxhir transmetimi të saktë nga Hudhejfe ibnul Jemani radijAllahu anhu.

Ky lloj i shirkut nuk e nxjerr muslimanin nga feja, as e bën të qëndrojë në Zjarr përgjithmonë, mirëpo bie në kundërshtim me plotësimin e detyrushëm të Teuhidit.

Lloji i tretë: është shirku i fshehtë. Argumenti i tij është thënia e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: **“A t’ju tregoj diçka që është më e frikshme për ju tek unë sesa Dexhali?!”** Thanë: “Po si jo o i Dërguari i Allahut.” Tha: **“Shirku i fshehtë; ngrihet ndonjëri njeriu për t’u falur dhe e zbukuron namazin e tij, sepse e vëren që po e shikojnë njerëzit.”** E transmeton imam Ahmedi në Musnedin e tij, nga Ebu Seid el Hudrij, radijAllahu anhu.

Lejohet që shirku të ndahet ndahet në vetëm dy lloje: i madh dhe i vogël, ndërsa shirkun e fshehtë e përfshijnë dy të parët.

Shirku i fshehtë mund të jetë prej shirkut të madh, sikur shirku i hipokritëve (munafikëve), sepse ata i fshehin besimet e tyre të kota dhe me syfaqësi e shfaqin Islamin, nga frika që kanë për vetet e tyre.

Shirku i fshehtë mund të jetë prej shirkut të vogël, sikur syfaqësia që u përmend në hadithin e Mahmud ibën Lebijd el Ensariut që u përmend më herët dhe në hadithin e Ebu Seidit që sapo u përmend. Prej Allahut vjen sukcesi!

Mësimi i pestë

IHSANI

Shtylla e Ihsanit është: të adhurosh Allahun sikur je duke e parë, edhe pse ti nuk e shikon, mirëpo Ai të shikon ty.

Mësimi i gjashtë

KUSHTET E NAMAZIT

Kushtet e namazit janë nëntë:

1. Islami.
2. Mendja.
3. Moshë e dallimit.
4. Largimi i papastërtisë (duke marrë abdes apo gusël).
5. Heqja e ndyrësisë.
6. Mbulimi i pjesëve të turpshme (auret).

7. Hyrja e kohës.
8. Drejtimi nga Kibla.
9. Nijeti.

Mësimi i shtatë

SHTYLLAT E NAMAZIT

Shtyllat e namazit janë katërmbëdhjetë:

1. Qëndrimi në këmbë nëse kihet mundësi.
2. Tekbiri fillestar.
3. Leximi i Fatihasë.
4. Rukuja.
5. Drejtimi në këmbë pas rukusë.
6. Bërja sexhde mbi shtatë gjymtyrë.
7. Ngritja nga sexhdja.
8. Ulja midis dy sexhdeve.
9. Qetësimi në të gjitha veprimet.
10. Renditja e shtyllave të namazit.
11. Teshehudi i fundit.
12. Ulja në teshehudin e fundit.
13. Dërgimi salavat për Pejgamberin sal-lallahu alejhi
ue sel-lem.
14. Dhe dy selamet.

Mësimi i tetë

OBLIGIMET E NAMAZIT

Obligimet e namazit janë tetë:

1. Të gjitha tekbiret përveç tekbirit fillestar,
2. Të thotë imami dhe ai që falet pas tij:

سَمِعَ اللَّهُ لِمَنْ حَمِدَهُ

“Samia Allahu limen hamideh” – Allahu dëgjon dhe i përgjigjet atij që e lëvdon!

3. Të thonë të gjithë:

رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ

“Rabbenā ue lekel hamd” – Zoti ynë, Ty të takon lavdia!

4. Thënia në ruku:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْعَظِيمِ

“Subhāne rabbijel adhijm” – Larg çdo të mete je Ti, o Zoti im i Madhëruar!

5. Thënia në sexhde:

سُبْحَانَ رَبِّيَ الْأَعْلَى

“Subhāne rabbijel eala” – Larg çdo të mete je Ti, o Zoti im më i Larti!

6. Thënia midis dy sexhdeve:

رَبِّ اغْفِرْ لِي

“Rabbi igfir li” – O Zot, më fal mua!

7. Teshehudi i parë

8. Dhe ndenja në të.

Mësimi i nëntë

SQARIMI I TESHEHUDIT

Sqarimi i teshehudit, i cili është thënia:

التَّحِيَّاتُ لِلَّهِ وَالصَّلَوَاتُ وَالطَّيِّبَاتُ السَّلَامُ عَلَيْكَ أَيُّهَا النَّبِيُّ وَرَحْمَةُ اللَّهِ وَبَرَكَاتُهُ السَّلَامُ عَلَيْنَا
وَعَلَى عِبَادِ اللَّهِ الصَّالِحِينَ ، أَشْهَدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ وَأَشْهَدُ أَنَّ مُحَمَّدًا
عَبْدُهُ وَرَسُولُهُ

“Et-tehijjātu lil-lāhi, ues-salauātu, uet-tajjibātu. Es-selāmu alejke ejjuhen-nebijju ue rahmetullāhi ue berekātuhu. Es-selāmu alejnā ue alā ibadil-lahis-sālihīn. Esh’hedu en lā ilahe il-lAllāh ue esh’hedu enne Muhammeden abduhu ue resūluhu” – madhërimet, namazet dhe lutjet janë për Allahun. Shpëtimi, mëshira dhe begatia e Allahut qofshin mbi ty o Pejgamber. Shpëtimi qoftë mbi ne dhe mbi robërit e devotshëm të Allahut. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm e të pashoq dhe dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij.

Pastaj dërgon salavate për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe lutesh që Allahu ta begatojë duke thënë:

اللَّهُمَّ صَلِّ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا صَلَّيْتَ عَلَى إِبْرَاهِيمَ وَآلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ حَمِيدٌ
مَجِيدٌ، اللَّهُمَّ بَارِكْ عَلَى مُحَمَّدٍ وَعَلَى آلِ مُحَمَّدٍ كَمَا بَارَكْتَ عَلى إِبْرَاهِيمَ وَآلِ إِبْرَاهِيمَ إِنَّكَ
حَمِيدٌ مَجِيدٌ

“Allahumme sal-li alā Muhammedin ue alā āli Muhammedin, kemā sal-lejte alā Ibrahīme ue alā āli Ibrahīme, inneke Hamīdun Mexhīd. Allahumme bārik alā Muhammedin ue alā āli Muhammedin, kemā bārekte alā Ibrahīme ue alā āli Ibrahīme, inneke Hamīdun Mexhīd” – o Allah, lavdëroje Muhamedin dhe ndjekësit e tij, ashtu siç e lavdërove Ibrahimin dhe ndjekësit e tij, me të vërtetë Ti je i Shumlëvduar, Plotmadhështi. O Allah, begatoje Muhamedin dhe ndjekësit e tij, ashtu siç e begatove Ibrahimin dhe ndjekësit e tij, me të vërtetë Ti je i Shumlëvduar, Plotmadhështi.

Pas kësaj, në teshehudin e fundit i kërkon Allahut mbrojtje nga dënimi i Xhehenemit, nga dënimi i varrit, nga sprova e jetës, e vdekjes dhe nga e keqja e sprovës së Dexhalit gënjeshtar. Pastaj zgjedh lutjet që dëshiron të bësh, veçanërisht ato që kanë ardhur në Kuran dhe Sunet. Prej tyre është:

اللَّهُمَّ أَعِنِّي عَلَى ذِكْرِكَ وَشُكْرِكَ وَحُسْنِ عِبَادَتِكَ، اللَّهُمَّ إِنِّي ظَلَمْتُ نَفْسِي ظُلْمًا
كَثِيرًا، وَلَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا أَنْتَ، فَاعْفُرْ لِي مَغْفِرَةً مِنْ عِنْدِكَ، وَارْحَمْنِي إِنَّكَ أَنْتَ الْعَفُورُ
الرَّحِيمُ

“Allahumme ainnī alā dhikrike, ue shukrike, ue husni ibādetik. Allahumme innī dhalemto nefsī dhulmen kethīran,

lā jegfiru edh-dhunūbe il-lā ente, fegfir lī magfiraten min indike, uerhamnī inneke entel Gafūru er-Rahīm” - o Allah, më ndihmo të të përmend dhe të të përkujtoj Ty, të të falenderoj Ty dhe të të adhuroj mirë. O Allah, vërtet unë i kam bërë vetes shumë të padrejta dhe vetëm Ti i falë gjynahet, andaj më fal mua me mëshirë prej Teje dhe më mëshiro; vërtet Ti je Falësi, Mëshirëploti.

Në teshehudin e parë, pasi përfundon et-Tahijatin ngrihesh për në rekatin e tretë kur je duke falur namazet e drekës, iqindisë, akshamit dhe jacisë. Nëse dërgon salavate për Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem (pas përfundimit të et-Tahijatit), atëherë është edhe më mirë, sepse kjo është çfarë tregojnë përgjithësisht hadithet. Më pas ngrihesh për në rekatin e tretë.

Mësimi i dhjetë

SUNETET E NAMAZIT

Sunetet e namazit janë:

1. Lutja hapëse
2. Vendosja e dorës së djathtë mbi dorën e majtën mbi gjoks kur je në këmbë, para rukusë dhe pas saj.
3. Ngritja e duarve duke i patur gishtat e mbledhur dhe të drejtuar paralel me shpatullat, apo paralel me veshët kur bën tekbirin fillestar, kur bie për në ruku, kur ngrihesh nga rukuja dhe kur ngrihesh nga teshehudi i parë për në rekatin e tretë.
4. T'i thuash më shumë se një herë tesbihet e rukusë dhe të sexhdes.
5. Të thuash pas ngritjes nga rukuja lutjen:

رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ

“Rabbenā we lekel hamd” – Allahu e dëgjon, i përgjigjet atij që e lavdëron. Po ashtu të thuash më shumë se një herë lutjen për falje mes dy sexhdeve.

6. Mbajtja e kokës drejtë me shpinën kur je në ruku.
7. Largimi i krahëve nga ijet, largimi i stomakut nga kofshët dhe i kofshëve nga kërcinjtë kur bën sexhde.
8. Ngritja e bërrylave nga toka gjatë sexhdes.
9. Namazliu të ulet mbi këmbën e majtë të shtrirë, ndërsa këmbën e djathtë e mban drejtë (me gishta në tokë) gjatë teshehudit të parë dhe mes dy sexhdeve.
10. “Et-Teuerruk” në teshehudin e fundit, në namazet me katër rekater dhe në atë me tre, duke ulur anën e majtë në tokë, këmbën e majtë e fut nën këmbën e djathtë, ndërsa të djathtën e mban drejtë.
11. Bërja me shenjë me gishtin tregues në teshehudin e parë dhe të dytë, duke filluar nga koha që ulesh, deri në përfundim të teshehudit dhe e levizën kur lutesh.
12. Lavdërimi dhe lutja e Allahut që ta begatojë Muhamedin, ndjekësit e tij, Ibrahimin dhe ndjekësit e tij në teshehudin e parë.
13. Lutja në teshehudin e fundit.
14. Leximi me zë në namazet e sabahut, të xhumasë, të dy bajrameve, të namazit të shiut dhe në dy rekatet e para të namazeve të akshamit dhe jacisë.
15. Leximi pa zë në namazet e drekës, iqindisë, në rekatën e fundit të namazit të akshamit dhe në dy të fundit të jacisë.
16. Leximi i një pjese nga Kurani pas sures el Fatiha.

Gjithashtu t'i përmbahesh suneteve të tjera që janë transmetuar në namaz, përveç këtyre që kemi përmendur, si përshebull: lutjet e tjera pas thënies:

رَبَّنَا وَلَكَ الْحَمْدُ

“Rabbenā we lekel hamd” – Allahu e dëgjon, i përgjigjet atij që e lavdëron. Kjo është prej suneteve pas ngritjes nga rukuja për imamin, për atë që falet pas imamit dhe për atë që falet vetëm. Po ashtu, prej suneteve është vendosja e duarve me gishta të hapur mbi gjunjë kur bën rukunë.

Mësimi i njëmbëdhjetë

GJËRAT QË E PRISHIN NAMAZIN

Gjërat që e prishin namazin janë tetë:

1. Të folurit me qëllim duke qenë i vetëdijshëm dhe duke patur njohuri, ndërsa ai që është në harresë apo nuk ka njohuri (është i paditur), nuk e prish namazin me këtë gjë.
2. Qeshja.
3. E ushqyera.
4. Pirja.
5. Zbulimi i pjesëve të turpshme (auretit).
6. Devijimi i shumtë nga drejtimi i Kibles.
7. Lëvizjet e shumta dhe të një pas njëshme në namaz.
8. Prishja e pastërtisë (abdesit, tejemumit apo guslit).

Mësimi i dymbëdhjetë

KUSHTET E ABDESIT

Kushtet e abdesit janë dhjetë:

Islami, mendja, mosha e dallimit, nijeti, ta ketë qëllimin deri në fund dhe mos ta ndërpresë derisa ta përfundojë pastrimin, abdesi të merret pas përfundimit nga gjërat që e bëjnë abdesin të obliguar, pastrimi me ujë apo me gurë nga nevojat para se të merret abdes, uji të jetë i pastër dhe i lejuar, heqja e gjërave që e pengojnë depërtimin e ujit për në lëkurë dhe të hyjë koha e namazit për atë person që është gjithmonë i papastër (për shkak të sëmundjes).

Mësimi i trembëdhjetë

FARZET E ABDESIT

Kushtet e abdesit janë gjashtë:

1. Larja e fytyrës, pjesë e së cilës janë larja e gojës dhe hundës.
2. Larja e duarve deri në bërryla.
3. Fshirja e kokës me duar të lagura, pjesë e së cilës janë edhe veshët.
4. Larja e këmbëve deri në nyje.
5. Renditja.
6. Mosndërprerja gjatë marrjes së abdesit.

Është e pëlqyeshme që të përsëritet larja e fytyrës, duarve dhe këmbëve nga tre herë, kështu edhe për larjen e gojës dhe hundës, mirëpo obligimi është vetëm një herë. Sa i përket fshirjes së kokës, nuk pëlqehet përsëritja e saj, siç e tregojnë këtë gjë hadithet e sakta.

Mësimi i katërmbëdhjetë

GJËRAT QË E PRISHIN ABDESIN

Gjërat që e prishin abdesin janë gjashtë:

Çdo gjë që del nga dy vendet e jashtëqitjes, dalja e ndonjë ndyrësie të madhe nga trupi, ikja e vetëdijes me gjumë apo diçka tjetër, prekja e organit me dorë nga para ose nga mbrapa pa patur pengesë, konsumimi i mishit të devesë dhe dalja (dezertimi) nga Islami; Allahu na mbroftë dhe muslimanët nga kjo gjë.

Vërejtje e rëndësishme: sa i takon larjes së të vdekurit, më e sakta është se nuk e prish abdesin. Kjo është thënia e shumicës së dijetarëve, sepse nuk ka argument. Mirëpo, nëse dora e larësit e prek organin e të vdekurit pa pengesë, atëherë është obligim marrja e abdesit.

Larësi e ka për detyrë që mos ta prekë organin e të vdekurit pa pengesë. Edhe prekja e gruas, nuk e prish abdesin asnjëherë, goftë prekja me epsh, apo pa epsh sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, e kjo përderisa prej tij nuk del diçka, sepse Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem i ka puthur disa nga gratë e tij, e më pas është falur pa marrë abdes.

Kurse Fjala e Allahut të Lartësuar në dy ajetet e sureve en-Nisa' dhe el Maideh:

﴿أَوْلَمَسَّمُ الْنِّسَاءِ﴾

“**Apo keni prekur gratë tuaja** (keni patur marrëdhënie me to).” [En-Nisa’: 43 dhe el Maide: 6] është për qëllim marrëdhëniet me to, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve. Kjo është thënia e Ibën Abbasit radijAllahu anhume dhe i shumë dijetarëve prej brezave të parë dhe të mëvonshëm.

Prej Allahut vjen sukcesi!

Mësimi i pesëmbëdhjetë

STOLISJA ME MORALET E LIGJËRUARA PËR ÇDO MUSLIMAN

Stolisja me moralin e ligjëruara për çdo musliman, ku bëjnë pjesë: sinqeriteti, mbajtja e amanetit, ndershmëria, turpi, trimëria, bujaria, mbajtja e besës, distancimi nga çdo gjë që e ka ndaluar Allahu, të qenit fqinj i mirë, të ndihmuarit e nevojtarëve sipas mundësisë dhe morale të tjera që Kurani dhe Suneti kanë treguar për ligjërueshmërinë e tyre.

Mësimi i gjashtëmbëdhjetë

EDUKIMI ME EDUKATAT ISLAME

Edukimi me edukatat Islame, si: selami, buzëqeshja, të ushqyerit dhe pirja me dorën e djathtë, thënia “bismil-lah” para nisjes (së ushqimit apo pirjes), të thuash “el hamdulil-lah” në përfundim të tyre, të thuash “el hamdulil-lah” pas teshtitjes, t’i thuash atij që teshtinë:

يَرْحَمُكَ اللَّهُ

“JerhamukAllahu” – Allahu të mëshiroftë! Kjo pasi të ketë thënë “el hamdulil-lah”.

Përcjellja e xhenazes dhe varrosja e saj, edukatat fetare kur hyn në xhami, apo në shtëpi, apo kur del prej tyre, kur udhëton, edukata me prindërit, me të afërmit, me fqinjët, me të moshuarit dhe me të vegjëlit.

Urimi i atij që i ka lindur fëmijë, lutja për begati për atë që është sapomartuar, ngushëllimi në fatkeqësi dhe të tjera edukata Islame gjatë veshjes apo zhveshjes së rrobave apo këpucëve.

Mësimi i shtatëmbëdhjetë

PARALAJMËRIMI NGA SHIRKU DHE LLOJEVE TË NDRYSHME TË GJYNAHEVE

Duhet ruajtur dhe paralajmëruar nga shirku dhe llojet e ndryshme të gjynaheve. Prej tyre janë: shtatë gjynahet shkatërruese; bërja shirk Allahut, vrasja me pa të drejtë e njeriut që e ka ndaluar Allahu, ngrënia e kamatës, ngrënia e pasurisë së jetimit, dezertimi nga lufta, akuzimi i nderit të grave besimtare të ndershme e të pafajshme.

Prej gjynaheve janë edhe: mosrespektimi i prindërve, shkëputja e lidhjeve fisnore, dëshmia e rrenjshme, betimi i rrenjshëm, lëndimi i fqinjit, padrejtësia ndaj njerëzve në gjak, në pasuri dhe në nder, konsumimi i alkolit, luajtja bixhoz, përgojimi, bartja e fjalëve e të tjera gjëra që i ka ndaluar Allahu azze ue xhel-le apo Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Mësimi i tetëmbëdhjetë

PËRGATITJA E TË VDEKURIT, FALJA E XHENAZES DHE VARROSJA

Ja dhe detajet:

Së pari: është e ligjëruar që njeriut në prag të vdekjes, t'i kujtohet fjala La ilahe il-lAllah, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Kujtojani atyre që janë pranë vdekjes që të thonë La ilahe il-lAllah.”** Transmeton Muslimi në Sahihun e tij. Me “ata që janë pranë vdekjes”, në këtë hadith kihen për qëllim ata që i janë shfaqur shenjat e vdekjes.

Së dyti: nëse është e sigurtë se njeriu ka vdekur, atëherë i mbyllen sytë dhe i lidhen nofullat, sepse kështu është përcjellë në Sunet.

Së treti: është obligim larja e të vdekurit musliman, përveç kur është shehid, që ka vdekur në luftë, pasi në këtë rast nuk lahet dhe nuk i falet xhenazja, mirëpo varroset me rrobat e tij. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nuk ka larë asnjë nga të vdekurit në luftën e Uhudit dhe nuk ia ka falur xhenazen.

Së katërti: forma e larjes së të vdekurit.

I mbulohen pjesët e turpshme (aureti), pastaj ngrihet pak dhe i shtypet lehtë stomaku. Më pas, ai që e lan e mbështjellë dorën e tij me një rrobë apo të ngjashme, që ta pastrojë nga ndyrësitë (në vendet e turpshme). Pastaj i jep abdes si për namaz. Më pas, ia lan kokën dhe mjekrrën me ujë dhe sidër, apo të ngjashme. Pastaj lanë anën e djathtë të tij, e më pas atë të majtë. Pastaj e lanë një herë, dy herë, tre herë duke ia përshkuar çdo herë dorën në stomak dhe, nëse del diçka prej tij, atëherë i vendos pambuk apo diçka të ngjashme në pjesën anale. Nëse vazhdon të ketë jashtëqitje, atëherë i vendos baltë të ngrohtë, apo një mjet mjekësor bashkëkohor, sikur likoplasti apo e ngjashme me të.

Ia përsërit abdesin dhe nëse nuk pastrohet me tre herë, atëherë e lanë pesë apo shtatë herë. Pas kësaj, e fshin me një rrobë, ia parfumos sqetullat dhe gjymtyrët e sexhdes. Nëse ia parfumos të gjithë trupin është edhe më mirë. I jep parfum qefinit. Nëse i ka mustaqet dhe thonjtë e gjatë, atëherë ia shkurton, e nëse ia lë siç janë nuk ka problem. Flokët nuk ia krehën, vendin e turpshëm nuk ia rruan dhe as nuk e bën synet, sepse nuk ka argument për to. Gruas ia bën flokët tre gërsheta dhe ia hedh pas shpine.

Së pesti: qefinosja e të vdekurit.

Më e mira është që burri të qefinohet në tre copa të bardha, pa këmishë dhe pa çallmë, siç është bërë me Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, duke e mbështjellë një pas një me to. Nëse qefinohet me këmishë, me izar dhe një copë mbështjellëse, nuk ka problem. Gruaja qefinohet në pesë copa: këmishë, shami për kokën, izar dhe dy copa mbështjellëse. Djali i vogël qefinohet me një deri në tre copa, ndërsa vajza e vogël qefinohet me këmishë dhe dy copa mbështjellëse.

Është obligim për të gjithë që qefinosja të bëhet me të paktën një copë që e mbulon të gjithë trupin e të vdekurit, mirëpo,

nëse i vdekuri është me ihram (me rrobën e haxhit apo umres), atëherë lahet me ujë dhe sidër, pastaj qefinoset me dy copat e ihramit, apo me të tjera, pa ia mbuluar kokën apo fytyrën dhe gjithashtu pa e parfumosur, sepse në Ditën e Gjykimit ai do të ringjallet duke thënë telbijen. Kështu është vërtetuar hadithi nga Pejgamberi sal-Allahu alejhi ue sel-lem. Nëse një grua është me ihram, atëherë qefinoset sikur të tjerat, mirëpo nuk parfumoset, as nuk i mbulohet fytyra me perçe, as duart me dorashka, por i mbulohen fytyra dhe duart me qefinin në të cilin qefinoset, siç u përmend më lart forma e qefinosjes së gruas.

Së gjashti: njeriu që ka përparësi në larjen, në faljen e xhenazes dhe varrosjen e të vdekurit, është personi që i vdekuri e ka lënë posori, pastaj babai, më pas gjyshi, pastaj më i afërti prej trashigimtarëve sa i përket burrit.

Për gruan ka më shumë përparësi ajo që e ka lënë porosi, pastaj nëna, më pas gjyshja, pastaj më e afërta prej grave të saja. I lejohet dy bashkëshortëve që ta lajnë njëri-tjetrin, sepse Ebu Bekër es-Siddikun radijAllahu anhu e ka larë grua e tij, po ashtu Aliu radijAllahu anhu ka larë gruan e tij, Fatimen radijAllahu anhe.

Së shtati: forma e namazit të xhenazes.

Bën katër tekbire. Pas tekbirit të parë lexon Fatihanë, e nëse lexon pas saj një sure të shkurtë, një ajet apo dy, atëherë kjo është diçka e mirë, sepse është transmetuar hadithi i saktë nga Ibën Abbasi radijAllahu anhume për këtë gjë. Më pas, bën tekbirin e dytë dhe lexon salavatet siç i lexon në teshehudin e namazit. Pastaj bën tekbirin e tretë dhe thotë:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لِحَيِّنَا وَمَيِّتِنَا وَصَغِيرِنَا وَكَبِيرِنَا وَذَكَرْنَا وَأُنثَانَا وَشَاهِدِنَا وَعَائِنَا ، اللَّهُمَّ
مَنْ أَحْيَيْتَهُ مِنَّا فَأَحْيِهِ عَلَى الْإِسْلَامِ ، وَمَنْ تَوَفَّيْتَهُ مِنَّا فَتَوَفَّهُ عَلَى الْإِيمَانِ .

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُ وَارْحَمْهُ وَعَافِهِ وَاعْفُ عَنْهُ ، وَأَكْرِمْ نُزُلَهُ ، وَوَسِّعْ مَدْخَلَهُ ، وَاغْسِلْهُ
 بِالْمَاءِ وَالتَّلْجِ وَالْبَرَدِ ، وَنَقِّهِ مِنَ الْخَطَايَا كَمَا نَقَّيْتَ الثَّوْبَ الْأَبْيَضَ مِنَ الدَّنَسِ
 ، وَأَبْدِلْهُ دَارًا حَيْرًا مِنْ دَارِهِ ، وَأَهْلًا حَيْرًا مِنْ أَهْلِهِ ، وَأَدْخِلْهُ الْجَنَّةَ ، وَوَقِهِ فِتْنَةَ
 الْقَبْرِ وَعَذَابِ النَّارِ ، وَافْسِحْ لَهُ فِي قَبْرِهِ ، وَنَوِّرْ لَهُ فِيهِ ، اللَّهُمَّ لَا تَحْرِمْنَا أَجْرَهُ
 وَلَا تُضِلَّنَا بَعْدَهُ

**“Allahumme igfir lihajjinē, ue mejjitinē, ue sagīrinē, ue
 kebīrinē, ue dhekerinē, ue unthēnē, ue shehīdinē, ue gāibinē.
 Allahumme men ahjejtehu minnē fe ahjihi alal Islām, ue men
 teueffejtehu minnē fe teueffehu alal imān. Allahumme igfir
 lehu uerhamhu, ue āfihi uafu anhu, ue ekrim nuzulehu, ue
 uessia’ mudkhalehu, uegsilhu bil mēi ueth-thelxhi uel berad,
 ue nekkihi minel khatājē keme junekka eth-theubul ejadu
 mined-denes, ue ebdilhu dēran khajran min dērihi, ue ehlen
 khajran min ehlihi, ue edkhillu el xhennete, ue kihī fitnetel
 kabri ue adhēben-nār, uefsih lehu fī kabrihi, ue neuir lehu fīhi.
 Allahumme la tahrīmē exhrahu, ue la tudil-lenē ba’dehu”** – o
 Allah, fali të gjallët tanë, të vdekurit tanë, ata që janë prezentë dhe
 ata që nuk janë, të vegjëlit tanë dhe të medhenjtë, burrat dhe gratë
 tona. O Allah, kujt i jep jetë, jepi jetë në Islam dhe kë e vdes, merrja
 shpirtin në besim. O Allah fale, mëshiroje, mbroje nga dënimi dhe
 toleroje, nderoje me grada, zgjeroja varrin dhe Xhenetin, pastroje
 me ujë, borë dhe breshër, pastroje nga gjynahet ashtu siç pastrohet
 rroba e bardhë nga ndotja, jepi vendbanim më të mirë se ç’ka patur,
 familje më të mirë se ç’ka patur, fute në Xhenet, mbroje nga dënimi
 i varrit dhe i Zjarrit, bëja varrin e gjerë dhe ndriçoja. O Allah, mos
 na privo nga shpërblimi i kësaj xhenazeje dhe mos na humb pas saj.
 Pastaj bën tekbinin e katërt dhe jep një selam në krahun e djathtë.

Pëlqehet që për çdo tekbir të ngrihen duart. Nëse i vdekuri është grua, atëherë thuhet:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهَا

“Allahumme igfir lehā... – o Allah, fale atë...”, deri në fund të lutjes. Nëse xhenazja i falet dy vetave, atëherë thuhet:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُمَا

“Allahumme igfir lehumā... – o Allah, fali ata dy...”, deri në fund të lutjes. Nëse xhenazja i falet më shumë se dy vetave, atëherë thuhet:

اللَّهُمَّ اغْفِرْ لَهُمْ

“Allahumme igfir lehum... – o Allah, fali ata...”, deri në fund të lutjes.

Nëse xhenazja është fëmijë, në vend të lutjes për falje, thuhet:

اللَّهُمَّ اجْعَلْهُ فَرْطًا وَذُخْرًا لَوَالِدَيْهِ، وَشَفِيعًا مُجَابًا، اللَّهُمَّ تَقَلَّ بِهِ مَوَازِينَهُمَا، وَأَعْظَمَ بِهِ أُجُورَهُمَا، وَالْحَقْمَةَ بِصَالِحِ الْمُؤْمِنِينَ، وَاجْعَلْهُ فِي كِفَالَةِ إِبْرَاهِيمَ عَلَيْهِ الصَّلَاةُ وَالسَّلَامُ، وَقِهِ بِرَحْمَتِكَ عَذَابَ الْجَحِيمِ

“Allahumme ixhalhu feratan ue dhukhran liuēlidejhi, ue shefian muxhēben. Allahumme thekkil bihi meuāzīnehume, ue eadhim bihi uxhūrahume, ue elhikhu bisālīhil mu’minīn, uexhalhu fī kefēleti Ibrāhīme alejhis-salātu ues-selām, ue kihi birahmetike adhebel xhahīm – o

Allah, bëje shpërblim paraprak dhe të ruajtur për prindërit e tij, bëje ndërmjetës të pranueshëm. O Allah, rëndoja atyre peshoren me të, jepi atyre shpërblim të madh me të dhe bëje pjesë të brezave të parë të devotshëm besimtarë. Vendose nën kujdesin e Ibrahimit alejhiss-salatu ues-selam dhe mbroje me mëshirën Tënde nga dënimi i Zjarrit”.

Suneti është që imami të qëndrojë tek koka e burrit dhe tek gruaja të qëndrojë në mes. Nëse janë shumë xhenaze, atëherë burri vendoset para imamit, ndërsa gruaja më afër Kibles. Nëse bashkë me ta gjendet edhe xhenazja e një djali të vogël, atëherë vendoset para gruas dhe pas gruas vendoset vajza e vogël. Koka e djalit të vogël vendoset në drejtim me kokën e burrit, mesi i gruas vendoset në drejtim të kokës së burrit, ndërsa vajza e vogël vendoset në drejtim me kokën e gruas dhe mesi i saj në drejtim të kokës së burrit. Të gjithë namazlitë qëndrojnë pas imamit, përveç kur ndonjëri nuk gjen vend pas imamit, ku në këtë rast qëndron në të djathtën e tij.

Së teti: forma e varrosjes së xhenazes.

Është e ligjëruar që varri të thellohet deri tek mesi i burrit dhe të hapet lahd në anën e Kibles. Xhenazja të vendoset në lahd në anën e tij të djathtë dhe t'i zgjidhen nyjet e qefinit, duke mos i hequr, por duke i lënë aty. Fytyra e tij nuk zbulohet, qoftë burrë apo grua. Më pas, vendosen pllaka dhëje dhe mbyllet me baltë, që të qëndrojë dhe mos të depërtojë dhëja. Nëse nuk gjenden pllakat e dhësë atëherë përdoren pllaka dërrase, ku më pas hidhet dhëja. Pëlqehet që në këtë rast të thuhet:

بِسْمِ اللَّهِ وَعَلَىٰ مِلَّةِ رَسُولِ اللَّهِ

“Bismil-lāhi ue ala mil-leti resūlil-lāh” – me emrin e Allahut dhe sipas Fesë së Pejgamberit. Varri ngrihet një pëllëmbë

dhe mbi të vendosen gurë të vegjël nëse është e mundur, e pastaj laget me ujë.

Ligjërohet që përcjellësit e xhenazes të qëndrojnë tek varri e të luten për të vdekurin, sepse kur Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem përfundonte varrosjen e një të vdekuri, qëndronte dhe thoshte: **“Kërkoni falje për vëllaun tuaj dhe kërkoni që të forcohet, sepse ai tani pyetet.”**

Së nënti: është e ligjëruar për atë që nuk e ka falur xhenazen, që t’ia falë pas varrosjes, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e ka bërë këtë gjë, mirëpo me kusht që së paku të jetë brenda një muaji apo më pak, e nëse ka kaluar kohë më shumë, atëherë nuk ligjërohet falja e xhenazes tek varri, ngase nuk është përcjellë që Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem të ketë falur xhenazen tek varri pas një muaji që i vdekuri është varrosur.

Së dhjeti: familjarëve të të vdekurit nuk i lejohet që të gatuajnë ushqim për njerëzit, sepse sahabiu i nderuar, Xherir ibën Abdullah el Bexhelij radijAllahu anhu, ka thënë: **“Tubimin tek familjarët e të vdekurit dhe gatimin e ushqimit pas varrosjes, i konsideronim prej vajtimit.”** E transmeton imam Ahmedi me zinxhir transmetimi të mirë. Sa i përket gatimit për ta,² apo për miqtë e tyre, kjo nuk ka problem. Ligjërohet që të afërmit dhe fqinjët e tyre të gatuajnë ushqim për ta, sepse kur Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i erdhi lajmi i vdekjes së Xhaferr ibën Ebi Talib radijAllahu anhu në Sham, i urdhëroi familjarëve të tij që të gatuanin për familjen e Xhaferrit, dhe pat thënë: **“I ka rënë ajo që i angazhon.”**

² D.m.th. gatimi për familjarët e të vdekurit. (shp)

Nuk ka problem nëse familjarët i thërrasin fqinjët apo të tjerë që të ushqehen nga ushqimi që u është dhuruar, e mesa kemi njëhuri rreth Fesë, kjo gjë nuk është e përcaktuar me afat kohor.

Së njëmbëdhjeti: gruas nuk i lejohet të mbajë zi mbi tre ditë, përveçse për burrin e saj, për të cilin duhet të mbajë zi katër muaj e dhjetë ditë. Nëse është shtatzënë, atëherë mban zi derisa të lindë, sepse kjo gjë është vërtetuar me hadithe të sakta nga Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Burrit nuk i lejohet të mbajë zi për ndonjë të afërt apo dikë tjetër.

Së dymbëdhjeti: ligjërohet që burrat të vizitojnë varrezat herë pas here, për t'u lutur për ta, për të kërkuar mëshirë për ta dhe për të përkujtuar vdekjen, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Vizitoni varrezat, sepse ato iu përkujtojnë Botën Tjetër.”** E transmeton Muslimi në Sahihun e tij. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i mësonte shokët e tij që kur të vizitonin varrezat, të thonin:

السَّلَامُ عَلَيْكُمْ أَهْلَ الدِّيَارِ، مِنَ الْمُؤْمِنِينَ، وَالْمُسْلِمِينَ، وَإِنَّا إِنْ شَاءَ اللَّهُ بِكُمْ لَاحِقُونَ،
أَسْأَلُ اللَّهَ لَنَا وَلَكُمْ الْعَافِيَةَ، وَيَرْحَمُ اللَّهُ الْمُسْتَفْدِمِينَ مِنَّا وَالْمُسْتَأْخِرِينَ

“Es-selāmu alejkum ehle ed-dijāri minel mu’minīne uel muslimīn, ue innē in shā Allahu bikum lāhikūn. Nes’elullāhe lenā ue lekumul āfijeh. Jerhamullāhu el mestekdimīne minnē uel meste’khirīn” – shpëtimi qoftë mbi ju, o banorë besimtarë dhe muslimanë të këtyre varreve. Ne, ins ha Allah do ju bashkangjitemi juve. E lusim Allahun për vete dhe për ju që të na japë mirëqenie. Allahu i mëshiroftë ata që na paraprinë dhe të mëvonshmit.

Grave nuk u lejohet vizita e varrezave, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka mallkuar gratë që i vizitojnë varrezat, pasi kihet frikë që kur t'i vizitojnë varrezat të sprovohen dhe mos të tregojnë durim. Atyre gjithashtu nuk i lejohet që të përcjellin xhenazen për në varreza, sepse Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka ndaluar nga kjo gjë. Atyre i lejohet falja e namazit të xhenazes në xhami apo në faltore, pasi kjo gjë është e ligjëruar për burrat dhe gratë

Kjo është çfarë na u mundësua të mbledhim. Lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, familjen dhe shokët e tij.